



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA DEMOKRACIA E RE EUROPIANE, PJESËTARE E KOALICIONIT "SHPRESA PËR NDRYSHIM", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Fier të paraqitura nga Partia "Demokracia e Re Europiane" pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Demokracia e Re Europiane, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Demokracia e Re Europiane, me vendimin e KQZ-së nr. 109, datë 27.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar koalicioni "Shpresa për Ndryshim", pjesë e të cilit është dhe Partia Demokracia e Re Europiane.



Nr. 631 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Demokracia e Re Europiane", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Fier. KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Lezhë me vendimin nr. 523 datë 18.05.2019.
- Fier me vendimin nr. 557 datë 18.05.2019.

Brenda afatit Partia Demokracia e Re Europiane, e kanë plotësuar dokumentacionin sipas vendimeve të KQZ-së për Bashkinë Lezhë dhe Fier.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Fier; pasi bashkitë Lezhë, Fier administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Lezhë, Fier ;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtarë këshilli në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Fier, të propozuar nga Partia Demokracia e Re Europiane;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetimet e Kuvendit të Shqipërisë, për zotërimin e 6 mandateve të z. Koçi Tahiri, zj.Elda Hoti, zj.Majlinda Halilaj, z. Zef Shtjefni, z.Kostaq Papa, z.Adriatik Alimadhi, dorëzuar me shkresën përcjellëse me nr. 4031 prot, datë 20.05.2019 sipas të cilit vërtetohet se koalicioni zotëron 6 mandate në Kuvend sa numri i partive pjesëmarrëse.;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Lezhë, Fier, të Partisë Demokracia e Re Europiane dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në Këshillin Bashkiak që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.

Zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, Bashkia Fier. KQZ do të vazhdojë e procedurat të mëtejshme për verifikim.



Nr. 631 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Demokracia e Re Europiane", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidat për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Lezhë dhe Fier të Partisë Demokratike e Re Europiane pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 631 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Demokracia e Re Europiane", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019